

KONTRATË SHITJE KUOTASH

E lidhur në Tiranë, sot më 09 / 04 / 2018, ndermjet paleve si me poshte vijon:

Z. Arben Maloku, shtetas shqiptar, lindur me 13.09.1986 ne Tirane dhe banues ne Cekreze, mbajtes i dokumentit te identifikimit, Pasaporte, me Nr. BD6468860 dhe Nr. personal I60913052T, madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar, ketu e me poshte i njohur si SHITESI,

dhe

Z. Fatmir Firi shtetas shqiptar, lindur me 26.08.1969, lindur ne Erseke, Tirane, dhe banues ne Tirane, mbajtes i dokumentit te identifikimit, Karte Identiteti Nr.030977774 dhe Nr. Personal G90826054G, madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar, ketu e me poshte i njohur si BLERESI,

MEQENESE:

- A. Shitësi zotëron 100% te Kapitalit te Shoqërisë “ARB & TRANS -2010” Sh.p.k, një shoqëri e themeluar e qe funksionon sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, e regjistruar ne Regjistrin Tregtar Shqiptar me NIPT L0232501T, me seli ne adresen: Tirane, Zall Herr Ndertese 2 katshe ,100m larg ish Stallave Cekreze (me poshte referuar “*Shoqeria*”);
- B. Shitesit deshiron t`i shese Bleresit dhe Bleresi deshiron te bleje nga Shitesit 100 % te kapitalit te zoteruar nga Shitesit ne Shoqerine e siperpermendur.
- C. Në përputhje me Statutin e Shoqërisë dhe Ligjin Nr. 9901/2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, si dhe me vendimin bashkëlidhur te Ortakut te vetem te shoqerise, per shitjen e kuotave te shoqerise, Palet deshirojne te lidhin kete Kontrate.

PER SA ME SIPER, palët bien dakord si vijon:



1. Me nënshkrimin e kesaj Kontrate Shitesi i shet Bleresit dhe Bleresi blen nga Shitesi 100% te kuotave te kapitalit te Shoqerise "ARB & TRANS -2010" Sh.p.k
2. Transferimi i pronësisë mbi kuotat dhe regjistrimi i transferimit behet menjëherë me nënshkrimin e kësaj Kontrate dhe pavarësisht mënyrës se pagimit te çmimit te shitjes te përcaktuar këtu.
3. Çmimi i shitjes se kuotave, ne vlerën e përgjithshme të rënë dakord prej 100000 Leke. Çdo pagese qe perben pjese te çmimit te shitjes sipas kesaj kontrate ne favor te shitesit, do te behet ne llogarine bankare te shitesit prane Credins BANK,.
Palet deklarojne e garantojne reciprokisht njera-tjetren se çmimi i shitjes se kuotave eshte i drejte, i arsyeshem dhe i caktuar me vullnetin e lire e te plote te paleve.
4. Shitësi deklaron dhe garanton Blerësin se pjeset e kapitalit te transferuara ketu, janë ne pronesine e tij te plote e ligjore dhe te lira nga barra hipoteke apo pengje.
5. Blerësi pranon pronësinë e kuotave, 100% te kapitalit te Shoqërisë, duke njohur gjendjen e Shoqerise dhe bie dakord me të gjitha të drejtat dhe detyrimet e lindura nga zotërimi i kuotave brenda Shoqërisë, sipas përcaktimeve të Statutit të Shoqërisë dhe ligjit shqiptar. Me nënshkrimin e kesaj kontrate Bleresi behet zotërues i 100% te kuotave te kapitalit te Shoqerise.
6. Ne rast se Bleresi, brenda nje periudhe nje vjeçare nga data e nënshkrimit te kesaj kontrate, deshton ne shlyerjen e plote te pageses se vleres se plote te kuotave, atehere Shitesit i lind e drejta rimarrjes se 100% te kuotave te Shoqerise.
7. Bleresi mer persiper pagesen e detyrimeve tatimore qe lindin nga realizimi i ketij transaksioni lidhur me Tatimin ne Burim, per fitimin e realizuar nga shitja e kuotave.
8. Shitësi dhe Blerësi bien dakord të zbatojnë dhe të paraqesin që në kërkesën e parë të palës tjetër dhe/ose të Shoqërisë të gjitha dokumentet e nevojshme në mënyrë që të kryejnë të gjitha veprimet e nevojshme për regjistrimin e transferimit te kuotave objekt të kësaj Marrëveshjeje, pranë Qendrës Kombëtare e Biznesit si dhe në çdo autoritet tjetër Shqiptar sipas përcaktimeve të Ligjit Shqiptar.

Kjo Kontrate u hartua në 4 (katër) origjinale ne gjuhen Shqipe. Kontrata bazohet në nenin 705 të Kodit Civil (Shqiptar) dhe në Ligjin shqiptar "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", Nr. 9901, Date 14.04.2008. Marrëveshja pasi u lexua prej palëve, u gjend e rregullt, në përputhje me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë dhe u nënshkrua rregullisht prej tyre.

PALET

SHITESI

Arben Maloku




BLERESI

Fatmir Firi

